

RAPORTI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	
EMËRTIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS	Projektligj “Mbi tregtinë e produkteve që mund të përdoren për dënime kapitale, torturë ose dënime apo trajtime ç'njerëzore, ose degraduese”
MINISTRIA UDHËHEQËSE	Ministria e Mbrojtjes
FAZA E POLITIKËS/VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	Konsultim
BURIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS	Transpozim i BE-së
DIREKTIVË/RREGULLORE E BE-së	Rregullorja (EU) 2019/125 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 16 janar 2019 “Lidhur me tregtinë e disa mallrave që mund të përdoren për dënimin me vdekje, torturën apo trajtime ose dënime të tjera mizore, çnjerëzore apo trajtime ose dënime poshtëruese”, e rishikuar. Link: https://eur-lex.europa.eu/legal-content/en/TXT/?uri=CELEX:32019R0125
PUBLIKIMET DHE STRATEGJITË E LIDHURA	N/A
DATA E KONSULTIMIT PUBLIK	1.2.2021 -
DATA E VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	2.2.2021
A E KA SHQYRTUAR KRYEMINISTRIA VLERËSIMIN E NDIKIMIT? NËSE PO, JEPNI DATËN E SHQYRTIMIT	Po 7.5.2021
NUMRI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	2021 – MM– 1
TE DHËNA KONTAKTI (EMRI, E-MAIL, NUMRI I TELEFONIT TË PERSONIT TË KONTAKTIT)	Elton Hodaj e-mail-i: elton.hodaj@mod.gov.al Numri i telefonit: 0692242154 Blerim Çaka e-mail-i: blerim.caka@mod.gov.al Numri i telefonit:

PJESA 1: PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE (maksimumi 2 faqe)

PËRKUFIZIMI I PROBLEMIT

Cili është problemi në shqyrtim dhe cilat janë shkaqet e tij? Jepni arsytet e nevojës së ndërhyrjes së qeverisë. (jo më shumë se 10 rreshta)

Nevoja për ndërhyrje të qeverisë lind nga fakti se në kuadrin ligjor ekzistues mungon rregullimi për fushën e tregtisë apo prodhimit të mallrave dhe shërbimeve të cilat nuk kanë përdorim tjetër përveç për “ekzekutimin e dënimit me vdekje, torturave dhe trajtimeve dhe dënimeve të tjera mizore, degraduese ose çnjerëzore” (tani e tutje Keqtrajtimi), si dhe sektori në këtë fushë nuk është i kontrolluar.

Mallrat që mund të përdoret për Keqtrajtim nuk janë klasifikuar apo kategorizuar, por në fakt ato duhet të jenë të kategorizuara duke i ndarë në mallra që nuk mund të lejohen apsolutisht apo mund të jenë subjekt i kufizimeve të caktuara.

Mungon koncepti i operatorëve ekonomikë dhe si rrjedhojë nuk ka saktësim të përgjegjësi të këtyre operatorëve kundrejt aktivitetit ekonomik të cilin ushtrojnë. Gjithashtu, nuk ka rregulla me ndëshkime për mosmarrje të masave të nevojshme.

Nuk janë marë masat e nevojshme zbatuese pjesë e detyrimeve ndërkombëtare për ta ndaluar përdorimin e mallrave për “Këqtrajtim” në Republikën e Shqipërisë por edhe në vende të treta.

Legjislacioni aktual nuk është në përputhje me legjislacion BE, përkatësisht Rregulloren (EU) 2019/125 të Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të 16 janar 2019 “Lidhur me tregtinë e disa mallrave që mund të përdoren për dënimin me vdekje, torturën apo trajtime ose dënime të tjera mizore, çnjerëzore apo trajtime ose dënime poshtëruese”, e rishikuar.

OBJEKTIVAT

Cilat janë objektivat dhe rezultatet e synuara të propozimit? (jo më shumë se 7 rreshta)

- Vendosja e një rregullimi ligjor në fushën e tregtisë së mallrave dhe shërbimeve që mund të përdoren për ekzekutimin e dënimit me vdekje, torturave dhe trajtimeve dhe dënimeve të tjera mizore, degraduese ose çnjerëzore menjëher me miratimin rregullimit;
- Rregullimin dhe licencimin e tregtisë së pajisjeve që mund të keqpërdoren për tortura dhe këqtrajtime por që përdoren edhe nga agjencitë e zbatimit të ligjit. Gjithashtu, të kimikateve të caktuara farmaceutike, në mënyrë që të sigurohemi që ato nuk transferohen për përdorim në ekzekutimet injeksione vdekjeprurëse në vende të treta, por pa kufizuar tregtimin e kimikateve të tilla për qëllime të tjera të ligjshme, në një periudhë afatmesme;
- Rritja e standarteve të respektimit të të drejtave të njeriut nëpërmjet zbatimit të koventave ndërkombëtare dhe marrja e masave zbatuese kombëtare si pjesë integrale e detyrimit ndërkombëtar për ta ndaluar këtë praktikë, në një periudhë afatmesme
- Disiplinimi dhe qarkullimi i shërbimeve dhe reklamave që lidhen me këto produkte, duke i trajtuar sipas regjimit që ka produkti i cili reklamohet ose për të cilin ofrohet ndihma teknike;
- Parandalimi i dënimit me vdekje nga njëra anë, torturave dhe trajtimeve ose dënimeve të tjera mizore, çnjerëzore ose degraduese në vendet e treta, nga ana tjetër;
- Ndërgjegjësimi i operatorëve ekonomikë nëpërmjet përcaktimit të masave administrative dhe sanksionimit të kundravajtësve në një periudhë afatmesme.

OPSIONET E POLITIKAVE

Cilat janë opsionet kryesore të politikave? Duhet të bëni krahasimin e avantazheve/përfitimeve kryesore dhe të dizavantazheve/kostove të opsioneve të mundshme. (jo më shumë se 7 rreshta)

Opsioni 0 (status quo): Nuk do të ndërhyjmë me ndryshim apo politikë të re. Nuk do të kemi një kuadër rregullator. Tregu do funksionojë me të njëjtin status që funksionon në këto momente dhe do të vijojë të njëjtat problematika. Autoritet e mbikëqyrjes së tregut nuk do të mundën të adresojnë asnjë nga problematikat e identifikuar. Gjithashtu ky opsion nuk do të lejonte përafrim e legjislacionit Shqiptar me atë acquis sikurse përcaktohet në Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit. Kostot dhe përfitimet për aktorët e përfshirë do të jenë të pandryshueshme për arsye se problemet e identifikuar nuk do të adresohen dhe nuk do të gjejnë zgjidhje.

Opsioni 1 (jo rregullator): Ndërgjegjësimi i i operatorëve dhe i publikut nëpërmjet fushatave publicitare apo sensibilizuese (spote, broshura, etj). Pavarësisht rezultatit të mundshëm të përfituar nga këto fushata trajnim/edukimi, ky opsion nuk mund të merret në konsideratë pasi tregu do të vazhdojë të jetë i parregulluar dhe nuk parashikojmë që do të ndikojë në ndalimin e këtyre produkteve. Për këtë arsye nuk kemi llogaritur kostot e trajnimeve dhe sensibilizimit të operatorëve/qytetarëve. Gjithashtu ky opsion nuk do të lejonte përafrim e legjislacionit Shqiptar me atë acquis sikurse përcaktohet në Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit.

Opsioni 2 (rregullator): Hartimi i një ligji dhe më pas hartimi i akteve nënligjore për zbatimin e

këtyre ndryshimeve. Ky është opsioni i rekomanduar pasi do të mundësonte adresimin e të gjitha problematikave të identifikuara në Vlerësimin e Ndikimit. Kosto për qeverinë është 102.400 Lekë në vitin e parë të zbatimit të ligjit.

ANALIZA E NDIKIMEVE

Cilat janë ndikimet e opsionit të preferuar? Kjo duhet të përshkruajë ndikimet në mënyrë sasiore (monetare) dhe cilësore (narrative) mbi buxhetin dhe grupet e tjera të prekura. (jo më shumë se 10 rreshta)

Opsioni i preferuar është përzgjedhur Opsioni 2.

Ndikimi për qeverinë është kontrolli dhe mbikëqyrja e operatorëve ekonomikë dhe e tregut, përmbushja e detyrimeve në kuadër të përafrimit të legjislacionit me Acquis dhe minimizimi i ngjarjeve të padëshiruara (veprimtari të kundërligjshme ose abuzive).

Kosto totale për qeverinë është 102.400 Lekë në vitin e parë të zbatimit të ligjit të ri.

Sikurse kemi trajtuar në analizën e mposhtme nuk kemi informacione dhe të dhëna për operatorët që veprojnë në këtë biznes. Në këtë kuadër e kemi të pamundur të përcaktojmë ndikimet ndaj biznesit.

Impakti social është ndalimi i promovimit të shkaktuar nga mosveprimi i një sjellje më të ashpër ndaj të tjerëve dhe formimin e një kulture dhune.

Impakti mbi qytetarët apo grupet më të prekshme është mbrojtja e grupeve më vulnerabël (prekshme) që zakonisht përballen me një rrezik më të lartë të torturës dhe keqtrajtimit.

ARSYETIMI I OPSIONIT TË PREFERUAR

Shpjegoni arsyet për zgjedhjen e opsionit të preferuar. Ju lutemi jepni nëse është e mundur koston dhe përfitimin me vlerë të përcaktuar monetare. (jo më shumë se 7 rreshta)

Opsioni 2, pra hartimi dhe miratimi i një ligji është më i preferuari, pasi:

- Kosoto e ulët: Bazuar në analizën e mësipërme kosto përfitim është opsioni i cili do të bëjë të mundur adresimin e plotë të problematikave të identifikuara në VN.
- Realizimi i objektivave: Do të bëjë të mundur realizimin e të gjithë objektivave të Qeverisë.
- Përcaktimi i standardeve, mbikëqyrjes së tregut, masave administrative do të rregullojë tregun në këtë fushë të cilat realizohen nga opsione 2 do të sjellin rregullimin e tregut dhe ndalimin e përdorimit për qëllime çnjerëzore apo aksidente me pasoja për shëndetin e qytetarëve.
- Do të zbatohen Konventat në fuqi mbi të Drejtat e Njeriut.
- Do të bëjë të mundur realizimin e objektivit në lidhje me procesin e përafrimit të legjislacionit të BE-së, dhe adresimin e komenteve të Progres Raportit të Komisionit Evropian.

Kosto totale për qeverinë është 102.400 lekë.

Kostoja e përlogaritur në total e opsionit të preferuar mbi buxhetin e shtetit gjatë periudhës 3-vjeçare menjëherë pas miratimit të ligjit (kostoja në total në lek, çmimet aktuale, në terma nominalë):

Viti 1	Viti 2	Viti 3
102 400	0	0

KONSULTIMI

Jepni një përmbledhje të çdo konsultimi të kryer (me kë dhe si jeni konsultuar? (jo më shumë se 5 rreshta)

Ky seksion do të plotësohet direkte pas miratimit të AVN në parim nga Kryeministria

ZBATIMI DHE MONITORIMI

Si do të organizohen zbatimi dhe monitorimi?(jo më shumë se 5 rreshta)

Për zbatimi dhe monitorimi në opsionin e preferuar, do të ngarkohet:

- a) Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve (AKSHE), nën Ministrinë e Mbrojtjes për dhënien ose refuzimin e lejeve nëse aplikanti është i vendosur në Republikën Shqipërisë.
- b) struktura përgjegjëse në Ministrinë e Mbrojtjes (Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve) dhe doganat gjatë importit;
- c) organet tjera mbikëqyrëse dhe inspektuese, secila në përputhje me kompetencat e veta.

Indikatori final i suksesit të politikës është:

- a. Sigurimi që detyrimet e të gjithë operatorëve ekonomikë janë më të qarta brenda viti të parë të zbatimit të ligjit të ri;
- b. Ndalimin e shitjes në tregun shqiptar të mallrave që në thelb janë abuzive dhe nuk duhet të tregtohen fare;
- c. Ndalimin e shitjes në tregun shqiptar të këtyre mallarave nga subjekte pa licencë ose nga autoritete që nuk kanë objekt ligjor përdorimin e këtyre mallrave;

AKSHE duhet të hartojë një raport vjetor të aktivitetit publik, e cila do të përmbajë informacion mbi numrin e autorizimeve të marra, mallrat dhe vendet e prekura nga këto autorizime dhe një informacion në lidhje me vendimet e marra në lidhje me këto kërkesa.

Gjithashtu, politika do të monitorohet në mënyrë të vazhdueshme (analiza 12- mujore) nëpërmjet gjetjeve dhe shkeljeve të konstatuara nga grupet inspektuese.

PJESA 2: BAZA KRYESORE E ANALIZËS DHE E PROVAVE

Historik

Jepni kontekstin e politikës.

Tortura dhe trajtimi ose dënimi mizor, çnjerëzor ose degradues është i ndaluar në mënyrë absolute dhe përfshihet në një numër dokumentesh dhe traktatesh në të gjithë botën, ndër të cilat mund të përmëntim: Deklaratën Universale të Drejtave të Njeriut; Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër Torturës dhe Trajtimeve ose Ndëshkimeve të Tjera Mizore, Çnjerëzore ose Degraduese¹, Kartën e të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian (Karta)², Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore³, Konventa Evropiane për Parandalimin e Torturës e të Dënimeve ose ë Trajtimeve Çnjerëzore dhe Degraduese⁴.

Fusha e tregtisë (prodhim, import, eksport dhe kalim tranzit) të mallrave dhe shërbimeve të cilat nuk kanë përdorim tjetër përveç për “Keqtrajtimin” nuk është e rregulluar në Shqipëri. Ndërsa, mallra të cilat, duke marrë parasysh modelin dhe tiparet e tyre teknike, paraqesin një rrezik material të përdorimit për Keqtrajtim rregullohen me legjislacion të vecant, si dhe i nënshtrohen disa kufizimeve. Më konkretisht:

- Mallrat me përdorim të dyfishtë me Ligjin nr. 46, datë 23.7.2018 “Për kontrollin shtetëror të transferimeve ndërkombëtare të mallrave ushtarake dhe të artikujve e teknologjive me përdorim të

¹ Linku: <https://undocs.org/en/A/RES/74/143>

² Linku: <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?qid=1602762160731&uri=CELEX:12016P/TXT>.

³ Linku: <https://qbz.gov.al/previeë/d7edcf2a-557e-4b00-9302-8531d686e864>

⁴ Linku: <https://qbz.gov.al/eli/konvente/2014/11/03/92-1/94893c54-187f-4106-83ee-b2ee4fc9c8ce>

dyfishtë”⁵, të ndryshuar, si dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 91, datë 27.02.2019 “Për miratimin e listës së përditësuar të mallrave ushtarake dhe të listës të artikujve e teknologjive me përdorim të dyfishtë, objekt i kontrollit shtetëror të transferimeve ndërkombëtare”⁶;

- Armët e Zjarrit me Ligjin nr. 74/2014 “Për armët”⁷, të ndryshuar;
- Kimikatet farmaceutike me Ligjin nr. 27/2016 “Për menaxhimin e kimikateve”.⁸

Rregullorja 2019/125 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e 16 janar 2019 “Lidhur me tregtinë e disa mallrave që mund të përdoren për dënimin me vdekje, torturën apo trajtime ose dënime të tjera mizore, çnjerëzore apo trajtime ose dënime poshtëruese”, e rishikuar, është legjislacioni i BE-së dhe në zbatim të Marrëveshjes së stabilizim asociimit është i detyrueshëm për afrimi në legjislacionin Shqiptar. Rregullorja ka për qëllim të plotësojë një boshllëk të identifikuar në kontrollet e tregtisë të BE-së, që bazohet në të drejtat e njeriut.

Konventat në fushën e të drejtave të njeriut, në të cilat Shqipëria është palë mund të aksesohen në faqen zyrtare të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme.⁹

Problemi në shqyrtim

- *Përshkruani natyrën e problemit.*
- *Identifikoni shkaqet e problemit.*
- *Përshkruani shtrirjen e problemit.*
- *Identifikoni grupet e prekura nga ky problem - qeveria / biznesi / shoqëria civile / qytetarët.*
- *Vlerësoni nëse problemi mund të trajtohet ose jo përmes një ndryshimi të politikave.*

Pothuajse çdo pajisje ose armë mund të përdoret për të shkakuar Keqtrajtime. Raportet e Kombeve të Bashkuara (OKB), organeve rajonale dhe kombëtare të monitorimit¹⁰, si dhe organizatave jo-qeveritare të të drejtave të njeriut, kanë theksuar në mënyrë të përsëritur keqpërdorimin e pajisjeve të zbatimit të ligjit (shpesh të prodhuara në masë) në praktika Keqtrajtimi në të gjithë botën.

Në Republikën e Shqipërisë si problematika të evidentuara që shqyrtohen nga kjo VN janë:

1. Moszbatim i obligimeve ndërkombëtare nga konventat.

OKB ka ndaluar në formë absolute torturën (*Rezoluta e OKB-së e miratuar nga Asambleja e Përgjithshme në 18 Dhjetor 2019, A / RES / 74/143. Tortura dhe trajtime ose ndëshkime të tjera mizore, çnjerëzore ose degraduese*).

Gjithashtu, Karta e të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian (Karta) ka ndaluar dënimin me vdekje ose nënshtrimin ndaj torturave ose trajtimeve çnjerëzore ose poshtëruese ose dënimeve.

Neni 5 i Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut, Neni 7 i Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike dhe Neni 3 i Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, përcaktojnë një ndalim të pakushtëzuar, gjithëpërfshirës të torturës dhe trajtimit ose çfarëdo ndëshkimi mizor, çnjerëzor ose poshtërues. Parashikime të tjera, në veçanti Deklarata e OKB për Mbrojtjen e të Gjithë Personave nga Nënshtrimi ndaj Torturës dhe Trajtimeve ose Dënimeve të Tjera Mizore, Çnjerëzore ose Poshtëruese (4) dhe Konventa e vitit 1984 e OKB kundër Torturës dhe Trajtimeve

⁵ Linku: <https://qbz.gov.al/previeë/6cc4a0b0-af9e-45d4-a114-8c215bb31716/cons/20200727>

⁶ Linku: <https://ëëë.mod.gov.al/images/akteligjore/akshe/2019/vendim-2019-02-27-91.pdf>

⁷ Linku: <https://qbz.gov.al/previeë/dce21816-e7d3-4811-8c8c-0e9b3aef60ac/cons/20210125>

⁸ Linku: https://shendetesia.gov.al/ëp-content/uploads/2018/08/Ligj_nr._27.2016date_17.3.2016.pdf

⁹ Linku: <https://punetejashtme.gov.al/al/dokumenta/konventa-dhe-raporte-per-te-drejtat-e-njeriut>

¹⁰ Raportet e Nënkomitetit të OKB për Parandalimin e Torturës, Raportuesin e Posaçëm të OKB për Tortura dhe Trajtime ose Dënime Tjera Mizore, Çnjerëzore ose Degraduese, Komitetit të Këshillit të Evropës për Parandalimin e Torturës. Linku: <https://ëëë.ohchr.org/En/HRbodies/opcat/Pages/OPCATIndex.aspx> ; <https://ëëë.coe.int/en/ëëb/cpt>

apo Ndëshkimeve të Tjera Mizore, Çnjerëzore ose Poshtëuese, vendosin për një detyrim shteteve për të parandaluar torturën.

2. Nuk ka një mbikëqyrje të tregut të brendshëm nga autoritetet shtetërore.

Importimi i mallrave të cilat nuk kanë përdorim tjetër përveç për Keqtrajtim por edhe sigurimi i ndihmës teknike për këto mallra nuk është i kontrolluar. Mallrat mund të prodhohen apo tregtohen pa autorizim/ licencim. Gjithashtu, këto mallra mund të shiten pa kufizim tek të gjithë qytetarëve.

3. Nuk ka mbikëqyrje të eksportit dhe kalimit tranzit për në vende të treta .

Eksporti apo kalimi tranzit i mallrave të cilat nuk kanë përdorim tjetër përveç për Keqtrajtimit por edhe sigurimi i ndihmës teknike në vende të treta që nuk janë pjesë e BE nuk kanë rregullime apo kufizime, të cilat mund të çenojnë sigurinë njerëzore, pasi këto produkte/shërbime mund të përdoren për torturë apo dënime kapitale në vende të treta.

Gjykata Kushtetuese me Vendim nr. 65 datë 10.12.1999 shpalli si antikushtetues denimin me vdekje ne kohe paqe që parashikohej ne Kodin Penal (KP) dhe Kodin Penal Ushtarak (K.P.U), me anë të te cilit lehtësoi e shpejtoi pozicionimin e Kuvendit të R.Sh., për të bërë rregullimet perkatese në K.P., dhe K.P.U., si dhe ratifikimin e Protokollit Nr.6 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut , në nenin 1 të së cilës thuhet Denimi me vdekje do të hiqet. Askush nuk do të denohet me një dënim të tillë dhe askush nuk do të ekzekutohet .

Me ligjin Nr.9722, date 30.4.2007, Kuvendi i Shqiperise miratoi ndryshimet perkatese te ligjit nr.8003, date 28.9.1995 Kodi Penal Ushtarak i R.Sh., i ndryshuar, me ane te te cilave shfuqizonte denimin me vdekje nga dispozitat e K.P.U., parashikuar ne gjendje lufte apo gjendje te jashtezakonshme, duke shenuar nje progres ne legjislacionin penal per heqjen e denimit me vdekje ne Shqiperi, ne te gjitha rrethanat. Sistemi i kontrollit të eksportit të BE-së zbaton standarde të larta të kontrolleve dhe shërben si pikë referimi për shumë vende të botës, përfshirë edhe Shqipërinë. Kontrollat me përdorim të dyfishtë plotësojnë drejtpërdrejt kontrollat mbi eksportet e armëve dhe ndjekin objektiva kryesisht të ngjashëm. Rregullore ose direktiva të tjera gjithashtu luajnë një rol të rëndësishëm në rregullimin e tregtisë së sendeve të ndjeshme. Secila prej këtyre rregulloreve/direktivave merret ose me një kategori specifike dhe të ndryshme të artikujve dhe / ose përdorimet e fundit, ose adreson lloje të ndryshme të situatave.

Eksportet e artikujve me përdorim të dyfishtë (artikujt me përdorim të dyfishtë janë mallra dhe teknologji për përdorim civil por edhe ushtarak) mund të ndikojnë gjithashtu në të drejtat themelore, veçanërisht ato të njerëzve në vendet jo BE, të tilla si e drejta për jetë dhe ndalimi i torturës dhe trajtimit çnjerëzor dhe degradues, e drejta për siguri, etj. Rregullorja (KE) 125/2019 (Rregullorja "Anti-torturë") adreson në mënyrë specifike tregtinë që mund të keqpërdoret për të privuar një person nga jeta, përdorimi i të cilave mund ta ekspozojë një person ndaj torturave gjatë kufizimit të lirisë, kontrollit, trazirave ose vetëmbrojtjes.

4. Nuk ka koncept për operatorët ekonomikë (prodhues/importues/distributor/ofrues shërbimi).

Mungon koncepti i operatorëve ekonomikë dhe si rrjedhojë nuk ka saktësim të përgjegjësiive të këtyre operatorëve kundrejt aktivitetit ekonomik të cilin ushtrojnë. Përcaktimi i dhe ndarja e zinxhirit të furnizimit do të bëjë të mundur parandalimin dhe identifikimin e subjekteve të cilat mund të kryejnë shkelje gjate tregtimit të këtyre produkteve.

5. Nuk ka kategorizim të mallrave.

Nga legjislacioni i BE-së por edhe nga përdorimi final i tyre, mallrat që mund të përdoret për Keqtrajtim kategorizohen në 2 grupe të madha:

- mallra që në thelb janë abuzive dhe nuk duhet të tregtohen fare (import/eksport/tranzit). Këto mallra dhe përbërësit e tyre janë të krijuara ose përdoren për ekzekutimin e qenieve njerëzore ose për torturën/keqtrajtimin e tyre;
- mallra të cilat duhet ti nënshtohen disa kufizimeve. Këto mallra mund të kenë përdorime të ligjshme, të tilla si pajisjet që përdoren nga autoritetet e zbatimit të ligjit, si dhe kimikate të

caktuara farmaceutike, por mund të përdoren edhe për ekzekutimin e qenieve njerëzore ose për torturën/keqtrajtimin e tyre.

Mungesa e kategorizimit ka bërë që të gjithë artikujt të jenë në një shportë të përbashkët dhe nuk janë klasifikuar në produkte të cilat edhe mund të preken nga Legjislacioni BE apo dhe mund të përdoren për qëllime të tjera. Kjo mungesë kategorizimi ka bërë që produktet të kenë një mendim si për insiucionet por edhe për publikun.

6. Organet shtetërore nuk kanë informacion dhe nuk kontrollojnë këtë kategori artikujsh.

Nuk ka procedura ndalimi, autorizimi apo lëshimi liçense/autorizimi në Shqipëri dhe për këtë arsye nuk ka kontroll mbi tregun për këto mallra (mallra që në thelb janë abuzive dhe nuk duhet të tregtohen fare (import/eksport/tranzit) por edhe mallrat të cilat duhet ti nënshtohen disa kufizimeve).

Ky mungesë informacioni lejon hyrjen e mundshme të artikujve pa kontroll apo regjistrim, kalimin e mundshëm të tyre tranzit në vendet e treta (pa u kontroilluar apo licencuar) si dhe shitjen e mundshme të tyre në treg (pa kontroll dhe licencim).

7. Mungon përcaktimi i autoriteteve që duhet të mbikëqyrin tregun.

Nuk janë të përcaktuara autoritetet të cilat duhet të japin lejen për këto mallra (ose duhet të mbikëqyrin/monitorojnë zbatimin e tij).

Mungesa e aurotitetit përgjegjës dhe caktimi i përgjegjësishë ligjore/administrative për të mbikëqyrur këto artikuj lejon hyrjen e mundshme të artikujve pa kontroll apo regjistrim, kalimin e mundshëm të tyre tranzit në vendet e treta (pa u kontroilluar apo licencuar) si dhe shitjen e mundshme të tyre në treg (pa kontroll dhe licencim).

Mungesa e autoriteteve përgjegjëse krijon hapsiara që këto mallra të prodhohen, importohen dhe eksportohen pa pajisjen e caktuar dhe licencën prej tij. Sipas fushës së përgjegjësishë në procedura të ndryshme marrin pjesë organe të ndryshme të administratës publike. Për shembull në rastin e importit/eksportit të sendeve që do të përdoren për qëllime muzeore, merret mendimi i ministritë përgjegjëse për muzetë.

8. Nuk ka masa parandaluese dhe shtrënguese që detyrojnë operatorët të përmbushin detyrimet.

Duke qenë se mungojnë masat parandaluese, tregtimi i disa produkteve si spray me piper ose elektroshok që përdoren nga kompanitë privatë të sigurimit fizik, në rastin më të mirë është i ndaluar, në raste të tjera është evidentuar tregëtimi i tyre pa kriterë të posaçme, kufizime moshe masa sigurie gjatë përdorimit etj. Për arsye të mungesës ligjore, nuk ka të përcaktuara rregulla me ndëshkime për marrje të masave të nevojshme. Ndëshkimet duhet të përfshijnë sanksione administrative dhe penale.

9. Përdorimi për qëllime që cënojnë respektin për jetën e njeriut dhe të drejtat themelore të njeriut

Produktet të cilat nuk kanë përdorim tjetër përveç për Keqtrajtim mund të përdoren nga subjekte apo persona të cilat nuk janë të autorizuar dhe mund ti përdorin për qëllime cënojnë respektit për jetën e njeriut dhe të drejtat themelore të njeriut.

Natyra e produkteve të cilat synohet të rregulloj kjo iniciativë ligjore, ka një impakt të drejtëpërdrejtë në jetën, shëndetin dhe në kufizimin e të drejtave të njeriut. Këto produkte duhen kontrolluar dhatë importit në Republikën e Shqipërisë, por edhe në eksport pasi në shumë vende të botës cënohen të drejtat dhe liritë themeolre të njeriut nëprnjet këtyre produkteve dhe keqpërdorimit të tyre.

Për situatën në Shqipëri nuk kemi statistika mbi keqpërdorimin e produkteve të kësaj natyre.

Gjithashtu, nga përdorimi i mallrave mund të ndodhin aksidente të cilat kanë pasoja për shëndetin e qytetarëve. Shqipëria nuk ka statistika të dedikuara mbi numrin e aksidenteve që janë shkaktuar nga këto mallra prandaj është e mundur që mund të jenë evidentuar edhe aksidente nga artikujt e futur në treg.

10. Shqipëria nuk ndalon verpimet që mund të favorizojnë dhe/ose promovojnë torturën apo veprimet çnjerëzore, duke rezultuar në favorizim të dhunës, probleme në shëndetin dhe jetën e qytetarëve, si dhe parandalim të përdorimit të torturës

Duke marrë parasysh rëndësinë e veçantë që i kushtohet ndalimit të torturës, detyrimet tradicionale të shteteve për të respektuar, për të mbrojtur dhe për të përmbushur të drejtat e njeriut plotësohet nga një detyrim i mëtejshëm për të parandaluar torturat dhe format e tjera të keqtrajtimit.

Shtetet, përfshirë edhe Shqipërinë, në bazë të aderimeve dhe forumeve ndërkombëtare ku marri pjesë duhet të marrin masa pozitive për të parandaluar shfaqjen e tij. Në rastin konkret, Shqipëria nuk ka marrë masa për parandalimin e torturave dhe format e tjera të keqtrajtimit nëpërmjet këtyre mallrave, si në Shqipëri, por edhe që të përdoren në vende të treta, duke qënë se mallrat mund të kalojnë tranzit nga Shqipëria ose të shiten direkte nga operatorë Shqiptarë, të cilat mund të ndikojnë gjithashtu në të drejtat themelore.

Në këtë kuadër, Shqipëria duhet të marrë masa zbatuese kombëtare si pjesë integrale e detyrimit ndërkombëtar për ta parandaluar përdorimin e këtyre praktikave.

Është e vështirë të nxjerrsh një rezultat më të dhëna dhe pasojat që sjell promovimi ose mospromovimi i veprimeve dhe produkteve që favorizojnë torturën. Gjithëse, është e sigurtë që duhet të jetë e ndaluar promovimi i produkteve si p.sh Spry me piper, elektroskok, etj të cilat pavarësisht së përdoren për vetmbrojtje nuk mund të promovohen në publikun e gjerë.

Grupet e Prekura: Për problematikat e evidentuar mësipër si grupe të prekura janë identifikuar:

Qeveria/Institucionet Shtetërore: për të gjitha problematikat e sipërmendura do të nevojitet përfshirja e autoriteteve të mbikëqyrjes së tregut, si :

- Ministria e Mbrojtjes (Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve), për lëshimin e autorizimeve-lejes;
- Ministria e Financave dhe Ekonomisë me strukturën përgjegjëse të mbikëqyrjes së tregut, përkatësisht Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut;
- Ministria e Brendshme (Policia e Shtetit);
- Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, për të verifikuar përmbushjen e kushteve;
- Ministria e Kulturës, për mallra që do të ekspozohen në muze;

Gjithashtu, preket dhe Avokati i Popullit.

Këto institucione nuk preken në mënyrë direkte nga ndryshimet e kërkuara, pasi janë struktura ekzistuese të cilat kanë eksperiencë dhe stafin e nevojshëm për ushtrimin e kompetencave të jera të mundshme. Me ndryshimet që propozohen, këto struktura do të kenë një përcaktim më të qartë të detyrave dhe kompetencave të tyre.

Biznesi/operatorët ekonomikë: Në fillim duhet të theksojmë se nuk ka shifra të sakta ose gjithëpërfshirëse në dispozicion, të verifikueshme, mbi numrin e kompanive të përfshira në prodhimin, promovimin dhe furnizimin e mallrave të tilla të kontrolluara, as mbi numrin e transferimeve të sanksionuara, vëllimin dhe natyrën e mallrave transferuar, as mbi natyrën e marrësve të këtyre mallrave.

Për mallrat në kategorinë (ii) përfshijnë të cilat në thelb janë abuzive dhe nuk duhet të tregtohen fare (import/eksport/tranzit), në bazë të të dhënave zyrtare që kemi në dispozicion nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave disponohen veprime të bëra për vitin 2020 në Republikën e Shqipërisë për import të mallrave tip “pranga të trupëzuar për kyçet”, “pranga me zinxhirë” apo “kamzhikë”. Gjithsesi

duhet të sqarojmë se nga këto të dhëna nuk mund të vërtetojmë se janë mallra të cilat janë të përdorshme për këtë kategori apo janë për qëllime argëtuese dhe janë të paërdorshme për keqtrajtime.

Për mallrat në kategorinë (iii) të përfshijnë në veçanti mallra të krijuara për të frenuar qeniet njerëzore, armë dhe pajisje të krijuara me qëllim të kontrollit të trazirave ose vetëmbrojtjes, si dhe armë dhe pajisje që shpërndajnë substanca kimike irrituese me qëllim të kontrollit të trazirave ose të vetëmbrojtjes, në bazë të të dhënave zyrtare që kemi në dispozicion nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganve disponohen veprime të bëra për vitin 2020 në Republikën e Shqipërisë për import të mallrave tip “elektroshok në formë pistolete”. Në këtë drejtim kanë importuar mallra 2 operatorë ekonomik, me rreth 100 njësi të hyra në Shqipëri. Gjithashtu, nuk mund të përjashtojmë importe-eksporte apo kalime tranzit të materialeve të kësaj liste por të cilat për asrye të mungesës së klasifikimit/kategorizimit nuk janë rregjistruar me këtë emër dhe nuk mund të evidentohen.

Nuk disponojmë të dhëna për operatorë biznesi që prodhojnë ose ndërmjetësojnë për mallra të kësaj kategorie.

Është i nevojshëm rregjistrimi i këtyre materialeve për të kuptuar dhe saktësuar llojin e materialit, arsyen e përdorimit dhe nëse ka operatorë të tjerë që fusin këto produkte por nuk rregjistrohen me këtë kategori por në kategori të tjera.

Për mallrat në kategorinë (iv) të cilat përfshijnë në veçanti ilaçe/kimikate të destinuara për të shpëtuar dhe përmirësuar jetën dhe shëndetin e pacientëve, por që mund të kërkohen për t'u përdorur në injeksione vdekjeprurëse. Për t'u dhënë një autorizim global, kompanitë duhet të tregojnë se kanë kontrollat e duhura për të parandaluar shitjen e këtyre ilaçeve për t'u përdorur në ekzekutime.

Në bazë të të dhënave zyrtare që kemi në dispozicion nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganve disponohen veprime të bëra në Republikën e Shqipërisë për import të mallrave me të njëjtin kod reference dhe të cilat përdoren nga kompani të ndryshme farmaceutike për lëndë të para për prodhim medikamentesh për njerëzit apo për kafshët. Duhet të sqarojmë se nga këto të dhëna nuk mund të vërtetojmë se janë mallrat që përshkruhen nga direktiva apo janë të karakteristikave të tjera por kanë kode reference të njëta pasi evidentojmë këtë fakt nga kontrolli i bërë.

Në bazë të kësaj analize për të treja këto kategori nuk mund të shprehemi për sasinë e operatorëve ekonomik që veprojnë në këtë fushë por për qëllime të kësaj analize do të propozojmë se ekzistojnë. Ndërsa për njësitë dhe volumin ekonomik të bërë nuk mund të parashikojmë.

Konsumatorët: Produktet mund të përdoren për dënime kapitale, torturë ose dënime apo trajtime ç'njerëzore, ose degraduese.

Përjashtimet që bëhen në këto raste janë për muzetë në rastet e objekteve me vlera muzele, ose kompanitë prodhuese farmaceutike në rastet e kimikateve të ndryshme ose produkteve farmaceutike të cilat mund të përdoren për zhvillimin, testimin e produkteve të tjera të ligjshme. Gjithsesi në asnjë rast këto përjashtime nuk vlejnë për individë, konsumatorë.

Qytetarët. shoqëria civile (OJQ, organizata të specializuara të politikave, grupe studimore), universitete dhe / ose institucione akademike, ndër të cilat mund të përmendim¹¹:

- Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KSHH);
- Qendra Kombëtare për Trajtimin e Viktimave të Dhunës në Familje (QKTDHF);
- Qendra për Nisma Ligjore Qytetare;
- Terre des hommes Albania (TdHA)';
- Qendra Shqiptare për Rehabilitimin e Traumës dhe Torturës (ARCT);
- Zyra e UNICEF-it në Shqipëri. etj.

¹¹ Dokumenti “Studime në fushën e kriminologjisë, Tiranë, maj 2020” të OSCE, faqe 26. Linku: <https://ëëë.osce.org/files/f/documents/2/0/453198.pdf>

Arsyeja e ndërhyrjes

- Shpjegoni pse qeveria e sheh të nevojshme të ndërhyjë.
- Shpjegoni se çfarë shpreson të trajtojë qeveria nëpërmjet kësaj ndërhyrjeje.
- Shpjegoni se si i mbështet kjo ndërhyrje objektivat e nivelit të lartë të qeverisë.
- Rendisni punën ekzistuese që është realizuar tashmë.

Nevoja për ndërhyrje të qeverisë lind nga fakti se nuk ka kuadër ligjor ekzistues për kategorizimin, licencimin apo kontrollin e zbatimit të mallrave dhe shërbimeve që mund të përdoren për Këqtrajtim.

Gjithashtu, ndërhyrja është e nevojshme pasi përafron standarte të një shoqërie që zbaton të drejtat e njeriut, si dhe që ndjek dhe zbaton konventat ndërkombëtare për parandalimin e dënimit kapital, nga njëra anë, dhe torturave dhe trajtimeve të tjera mizore, çnjerëzore ose degraduese në vendet e treta. Shqipëria është e vendosur për ndalimin absolut të dënimit me vdekje, torturave ose çnjerëzore ose mizore të tjera ose trajtim ose ndëshkim degradues. Parandalimi dhe çrrënjësja e të gjitha trajtimeve ose ndëshkimeve të tilla në të gjithë botën është e ngulitur në të drejtat thelbësore të OKB-së, si dhe në nivelin e BE-së në Kartën e të Drejtave Themelore të BE-së.

Këto produkte mund të përdoren nga subjekte apo individë të cilat nuk janë të autorizuar dhe mund të përdoren për qëllime cënojnë respektin për jetën e njeriut dhe të drejtat themelore të njeriut.

Tregu i ligjshëm i këtyre produkteve është shumë i kufizuar, sipas rasteve të veçanta për produkte farmaceutike, mjekësore, veterinare apo në rastet e mallrave për muzetë. Pavarësisht kufizimit të aktorëve tregtarë të këtyre produkteve, impakti që ato do të kenë në rastet e një importi/eksporti të paligjshëm ose për qëllime të paligjshme është shumë i lartë në pasojat e respektit të jetës dhe të drejtave themelore të njeriut dhe për këtë qëllim ky treg duhet rregulluar me sistem licensimi/autorizimi për transferimet e këtyre produkteve (import/eksport/transit/ndërmjetësim/asistencë teknike etj).

Kategorizimi mallrave sipas standarteve Europiane, Lista II, III, IV dhe V, ku të jenë përcaktuar mallrat, si dhe e drejta ose jo për marrje tregtim/eksport/import.

Rregullimi si dhe ndalimi i shitjes/eksportit/importit së mallrave që përfshihen në listën II, apo lejimi i shitjes/eksportit/importit të mallrave që janë në listën II, IV. Apo V.

Detyrimet e personave të angazhuar në tregtinë e jashtme të mallrave për mbajtje të evidencave mbi tregtinë e jashtme të mallrave dhe njoftimin e autoritetit shtetëror mbikëqyrës.

Vendosja e procedurave ndalimit ose lejimit të importit/eksportit apo kalimit tranzit të mallrave nëpërmejt të licencimit për tregtinë e jashtme të mallrave dhe shërbimeve, pa kufizuar tregtimin e kimikateve të tilla për qëllime mjekësore, veterinare ose qëllime të tjera të ligjshme.

Ndërhyrja e qeverisë është e nevojshme për të mbështetur edhe objektivat e përcaktuara në dokumentet strategjike siç janë:

1. Në përmbushje të detyrimeve që Republika e Shqipërisë ka në kuadër të procesit të anëtarësimit në BE dhe të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit për të përafruar me detyrim në legjislacionin Shqiptar, legjislacionin e BE-së, neni 70 i MSA-së.¹²;
2. Për realizim të rekomandive të dhëna nga Komisioni Evropian në (Progres Raporti për Shqipërinë për vitin 2018/2019/2020) në të cilat kërkohet nga qeveria përafrimi i legjislacionit në fushën e torturës.¹³;

Puna ekzistuese që është realizuar tashmë:

¹²Linku: <http://dap.gov.al/publikime/dokumenta-strategjik/61-marreveshja-e-stabilizim-asociimit>

¹³Linku: <https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20180417-albania-report.pdf>

Ministria e Mbrojtjes, ka analizuar kuadrin ligjor në republikën e Shqipërisë, detyrimet që rrjedhin nga Konventat për të Drejtat e Njeriut, ka analizuar aktet rregullatorë të bashkimit Europian në lidhje me këto produkte që mund të përdoren për ekzekutimin e dënimit me vdekje, torturave dhe trajtimeve dhe dënimeve të tjera mizore, degraduese ose çnjerëzore.

Gjithshtu, ka analizuar legjislacionin e vendeve të rajonit në këtë fushë. Ka marrë të dhënat nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave në lidhje me identifikimin e operatorëve ekonomikë të cilët mund të importojnë / eksportojnë këto produkte. Ka vendosur kontakte me insitucionin e Avokatit të Popullit .

Objektivi i politikës

- a) *Vendosni objektiva që korrespondojnë me problemin dhe shkaqet e tij.*
 - b) *Sigurohuni që objektivat e vendosur të korrespondojnë me ato të dhëna në përmbledhjen ekzekutive, por më të detajuara.*
 - c) *Sigurohuni që objektivat janë specifike, të matshëm, të arritshëm, realë dhe në kohë.*
- Objektivat e propozimit janë:

- (a) Vendosja e një rregullimi ligjor në fushën e tregtisë së mallrave dhe shërbimeve që mund të përdoren për ekzekutimin e dënimit me vdekje, torturave dhe trajtimeve dhe dënimeve të tjera mizore, degraduese ose çnjerëzore menjëher me miratimin rregullimit;
- (b) Rregullimin dhe licencimin e tregtisë së pajisjeve që mund të keqpërdoren për tortura dhe keqtrajtime por që përdoren edhe nga agjencitë e zbatimit të ligjit. Gjithashtu, të kimikateve të caktuara farmaceutike, në mënyrë që të sigurohemi që ato nuk transferohen për përdorim në ekzekutimet injeksione vdekjeprurëse në vende të treta, por pa kufizuar tregtimin e kimikateve të tilla për qëllime të tjera të ligjshme, në një periudhë afatmesme (deri në 1 vit);
- (c) Rritja e standarteve të respektimit të të drejtave të njeriut nëpërmjet zbatimit të konventave ndërkombëtare dhe marrja e masave zbatuese kombëtare si pjesë integrale e detyrimit ndërkombëtar për ta ndaluar këtë praktikë, në një periudhë afatmesme (deri në 1 vit) ;
- (d) Parandalimi i dënimit me vdekje nga njëra ane, torturave dhe trajtimeve ose dënimeve të tjera mizore, çnjerëzore ose degraduese në vendet e treta, nga ana tjetër;
- (e) Disiplinimi dhe qarkullimi i shërbimeve dhe reklamave që lidhen me këto produkte, duke i trajtuar sipas regjimit që ka produkti i cili reklamohet ose për të cilin ofrohet ndihma teknike;
- (f) Ndërgjegjësimi i operatorëve ekonomikë nëpërmjet përcaktimit të masave administrative dhe sanksionimit e kundravajtësëve në një periudhë afatmesme.

Përshkrimi i opsioneve të shqyrtuara

- *Përshkruani opsionin e status quo-së.*
- *Identifikoni dhe përshkruani të gjitha opsionet e politikave që keni marrë parasysh.*
- *Shpjegoni se si janë identifikuar opsionet e politikës.*

Për arritjen e objektivave të politikës janë shqyrtuar opsionet e mëposhtme:

- **Opsioni 0 (status quo):** Nuk do të ndërhyjmë me ndryshim apo politikë të re, e cila do të sjell mospasje të një kuadri rregullator. Tregu do funksionojë me të njëjtin status që funksionon në këto momente dhe do të vijojë të njëjtat problematika.

Autoritet e mbikëqyrjes së tregut nuk do të mundën të adresojnë asnjë nga problematikat e identifikuar. Prodhimi, eksporti dhe kalimi tranzit apo ofrimi i shërbimeve do të vijojë të jetë i pa rregulluar dhe këto mallra/shërbime mund të përdoren brënda vendit apo në vende të treta për qëllime të dënimeve kapitale apo për torturë.

Kostot dhe përfitimet për aktorët e përfshirë do të jenë të pandryshueshme për arsye se problemet e identifikuar nuk do të adresohen dhe nuk do të gjejnë zgjidhje.

- **Opsioni 1 (jo rregullator):** Ndërgjegjësimi i i operatorëve dhe i publikut nëpërmjet fushatave publicitare apo sensibilizuese (spote, broshura, etj).

Për këtë opion mund të hartohen programe trajnimi dhe fushata sensibilizuese me spote apo broshura në lidhje dëmtët dhe pasojat që shkaktojnë këto mallra.

Pavarësisht rezultatit të mundshëm të përfituar nga këto fushata trajnim/edukimi, ky opion nuk mund të merret në konsideratë pasi tregu do të vazhdojë të jetë i parregulluar dhe nuk parashikojmë që do të ndikojë në ndalimin ekëtyre produkteve Për këtë arsye nuk kemi llogaritur kostot e trajnimeve dhe sensibilizimit të operatorëve/qytetarëve.

- Përfitimet për aktorët e përfshirë janë të vështira për tu vlerësuar pasi nuk ka qarkullim të këtyre artikujve ose qarkullim minimal.

- **Opsioni 2 (rregullator):** Hartimi i një ligji dhe më pas hartimi i akteve nënligjore për zbatimin e këtyre ndryshimeve.

Ky është opsioni i rekomanduar pasi do të mundësonte adresimin e të gjitha problematikave të identifikuar në VN.

Kosto totale për qeverinë është 102.400 Lekë në vitin e parë të zbatimit të ligjit të ri. Kosto bruon nga shuma e mbledhur e koston njohjes më legjislacionin e ri / përshtatshmëria dhe e familjarizimit. Me konkretisht e keti te plotë më poshtë ne këtë RIA.

Vlerësimi i opsioneve/analizimi i ndikimeve

a) Identifikoni grupet e prekura.

b) Identifikoni llojet e ndikimeve për secilin grup të prekur, bëni dallimin midis ndikimeve të drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta.

c) Për ndikimet e drejtpërdrejta:

a. Përshkruani nga ana cilësore ndikimet e drejtpërdrejta mbi grupet e prekura.

b. Analizoni nga ana sasiore ndikimet më të rëndësishme të drejtpërdrejta.

c. Përcaktoni vlerën monetare të ndikimeve më të rëndësishme të drejtpërdrejta aty ku është e mundur (përdor tabelën në Aneksin 2/a të këtij dokumenti).

d. Analizoni ndikimin mbi ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (nëse ka).

d) Për ndikimet jo të drejtpërdrejta:

a. Përshkruani nga ana cilësore ndikimet jo të drejtpërdrejta mbi grupet e prekura.

b. Analizoni ndikimin mbi konkurrencën.

e) Diskutoni kufizimin e analizës:

a. Jepni supozimet në të cilat janë bazuar parashikimet dhe risqet, të cilave ato u nënshtrohen.

b. Tregoni se çfarë mund të pengojë realizimin e përfitimeve, të rrisë kostot ose të sjellë pasoja të papritura.

f) Përmbledhni vlerësimin e opsioneve:

a. Paraqisni një pasqyrë përmbledhëse të të gjitha ndikimeve të opsioneve të analizuara.

b. Shpjegoni se si ndikimet e të gjitha opsioneve të analizuara krahasohen me njëra-tjetrën.

c. Paraqisni përlllogaritjet më të mira të përgjithshme neto të ndikimit me vlerë monetare të përcaktuar për çdo opion (përdor tabelën në Aneksin 2/b të këtij dokumenti).

A. Grupet e prekura nga ky ndryshim ligjor janë:

Qeveria: Sikurse janë përmendur në pjesën e parë të kësaj Analize (përkatësisht Problematikat, ndikimet e drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta për qeverinë janë si më poshtë:

Qeveria/Institucionet Shtetërore: për të gjitha problematikat e sipërmendura do të nevojitet përfshirja e autoriteteve të mbikëqyrjes së tregut, si :

- Ministria e Mbrojtjes (Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve), për lëshimin e autorizimeve-lejes;
- Ministria e Financave dhe Ekonomisë me strukturën përgjegjëse të mbikëqyrjes së tregut, përkatësisht Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut;
- Ministria e Brendshme (Policia e Shtetit);
- Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, për të verifikuar përmbushjen e kushteve;
- Ministria e Kulturës, për mallra që do të ekspozohen në muze;

Gjithashtu, preket dhe Avokati i Popullit.

Ndikime të drejtpërdrejta:

- Përmirësimi i koordinimit dhe bashkëpunimit ndërinstitucional./ Ndarja e përgjegjësisë dhe kompetencave midis autoriteteve të mbikëqyrjes së tregut;
- Përmirësimi i kontrollit dhe mbikëqyrja e operatorëve ekonomikë;
- Përmbushja e detyrimeve në kuadër të përafrimit të legjislacionit me Acquis.
- Standartizimi i tregut dhe certifikimi i tij do të bëjë të mundur minimizimin e ngjarjeve të padëshiruara (veprimtari të kundërligjshme ose abuzive);
- Promovimi i respektit për jetën dhe të drejtat themelore të njeriut, në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

Si ndikim jo të drejtpërdrejtë përmendim krijimin e një imazhi pozitiv për Shqipërinë në mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

Operatorët Ekonomikë (Biznesi)

Sikurse kemi trajtuar në analizën e mposhtme nuk kemi informacione dhe të dhëna për operatorët që veprojnë në këtë biznes. Në këtë kuadër e kemi të pamundur të përcaktojmë ndikimet ndaj biznesit.

Impakti social: Lidhur me mjedisin shoqëror dhe kulturor vijimi i qëndrimit të mundësisë për sigurimin dhe përdorimin e këtyre mallrave (pra mungesa e një ndalimi) vijon të promovojë në mënyrë të heshtur dhunën ndaj njeriut dhe përdorimin e mjeteve të cilat shkaktojnë keqtrajtime. Aty ku ekziston një kulturë dhune, ose mbështetje e lartë publike për të qënë "i ashpër" ndaj krimit, rreziku që torturat të ndodhin është gjithashtu më i lartë. Por kjo situatë është edhe anasjelltas pasi mundësia e pasjes së mjeteve të tilla por edhe mundësia për të bërë biznes me artikuj të tillë mund të promovojë një sjellje më të ashpër ndaj të tjerëve dhe formimin e një kulture dhune.

Impakti mbi qytetarët apo grupet më të prekshme: Është e vështirë të identifikohen personat ose grupet që janë në rrezik më të madh daj mundësive për pësim të torturave dhe keqtrajtmeve, sepse mund të ndryshojnë ndjeshëm në përputhje me kontekstin lokal apo me atë kombëtar. Në fakt, çdo person potencialisht mund të jetë në rrezik. Në përgjithësisht, megjithatë, grupe të cënueshme dhe të pafavorizuara brenda shoqërisë - të tilla si grupet e pakicave (racore, etnike, fetare ose gjuhësore), gratë, të miturat, migrantët, personat me aftësi të kufizuara, të pastrehët dhe të varfër - zakonisht përballen me një rrezik më të lartë të torturës dhe keqtrajtimit.

A. Analiza e kostos

Për analizën e kostove do të përdorim 3 njësi matëse të cilat janë:

- a) Kosto e kohës,
- b) Kosto e njohjes me legjislacionin e ri / përshtatshmëria dhe

c) Madhësia e sektorit/numri i institucioneve të përfshira.

A. Kosto e kohës për qeverinë

Analiza që përdorim për të evidentuar koston e qeverisë përfshin koston për kohën e punëtorëve, e cila supozon se kostoja për organizatën për çfarëdo aktiviteti që bën për shkak të transpozimit të Direktivës do të jetë prodhim i humbur i asaj kohe për çështje të tjera.

Analiza e mëposhtme do llogarisë/kostoje kohën e punëtorëve bazuar në modelin e Kostos së Plotë Ekonomike (FEC), sipas të cilës supozohet se për një organizatë kosto për çdo aktivitet të kryer për shkak të transpozimit të Direktivës do të jetë prodhimi i humbur gjatë kësaj kohe.

Supozojmë se koha e punës është 40 orë në javë, e cila ndahet në 8 orë punë në ditë. Në funksion të llogarisë kemi përdorur fashën e orëve mujore të punës 160 orë pune. Lidhur me koston e një punonjësi shtetëror kemi marrë pagën mesatare për funksionin Specialistë me arsim të lartë (profesionistë) mujore 71,000 leke nga ku kosto/orës është 400 Lek./ora ¹⁴

B. Kosto e njohjes me legjislacionin e ri / përshtatshmëria

Supozojmë një periudhë përshtatshmërie prej 10 vjetësh, tabela (shtojca nr.2).

Ne supozojmë se kostot përballohen në vitin e parë të periudhës së përshtatshmërisë (Viti 0). Gjithashtu, supozojmë se kostot e vazhdueshme dhe kursimet e koston lindin çdo vit nga viti 0 deri në vitin 9, përveç nëse përcaktohet ndryshe.

C. **Ndikimet e diskutuara në këtë ligj do të përballohen nga** organi shtetëror i cili vlerëson mallrat dhe lëshon autorizimet;

Kosto e Qeverisë.

g) Rregullatori (Autoritetet e mbikëqyrjes së tregut dhe autoritetet licencuese)

Autoritet e mbikëqyrjes së tregut dhe autoritetet licencuese të cilat do të kryejnë funksionet monitoruese dhe kontrolluese për implementimin e këtij ligji nuk parashikohet të kenë kosto shtesë për sa i përket shtimit të kapaciteteve, trajnimeve të punonjësve ose ngritje struktura të reja.

Të gjitha institucionet e përcaktuara janë ekzistuese dhe kanë eksperiencën e duhur për zbatimin e detyrimeve që do të përcaktojnë ligji i ri.

h) Familjarizimi

Lidhur me familjarizimin vlerësohet se do të duhen rreth një deri në 2 ditë për të lexuar dhe kuptuar ndryshimet. Duke llogaritur koston e orës së punës 400 Lek/ora dhe 8 orët ditore dhe duke mbajtur në konsideratë se në Shqipëri do të preken 4 struktura (AKSHE-ja, Doganat, Ministria e Kultures dhe Policia e Shtetit) në mënyrë të drejtëpërdrejtë (për të cilat do të llogarisim koston e familjarizimit, me nga 4 personel për strukturë, kosto llogarit 102.400 Lek. Kjo kosto do të jetë vetëm një herë të vetme.

Kosto llogarit: 400 Lek/ora x 16 orë (2 ditë pune 8 orëshe) x 4 struktura x 4 personel = 102.400 lekë

i) Masat e reja

Forcimi i masave të sigurisë nënkupton që tani do të ketë detyrime për importuesit dhe shpërndarësit për të njoftuar autoritetet e mbikëqyrjes së tregut. Kjo nënkupton që këto autoritetet mund të marrin njoftime nga importuesit vendas por edhe nga autoritete të huaja për produktet. Administrimi i këtij informacioni nga Autoritetet dhe veprimet që do të ndërmerren në këto raste mund të sjellë kosto shtesë. Kjo kosto nuk mund të llogarit pasi mendohet se është minimale.

¹⁴ Burimi i informacionit: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, kontribuesit në Sigurime Shoqërore; Llogaritjetë INSTAT, Pagamesatare mujore brutopërnjëtëpunësuar me pagë sipas grup-profesioneve dhe heqjenisë, për Specialistë me arsim të lartë (profesionistë), <http://ëëë.instat.gov.al/al/temat/tregu-i-pun%C3%ABs-dhe-arsimi/pagat/#tab2>

Kosto totale për qeverinë është 102.400 Lek lekë në vitin e parë të zbatimit të ligjit të ri.

Kosto e Biznesit

Sikurse e kemi përmendur më sipër, veprimtaria për mallrat që preken nga ky rregullim nuk është e rregulluar dhe nuk ka mbikëqyrje të institucioneve shtetërore. Nuk kemi të dhëna për numrin e operatorëve që veprojnë apo për sasinë e mallrave që hynë për artikujt që preken në listat e Rregullores BE. Në këtë situatë nuk mund të realizojmë një analizë kosto për biznesin.

Arsyetimi i opsionit të preferuar

- *Zgjidhni opsionin e preferuar, bazuar në analizë.*
- *Shpjegoni arsyetimin tuaj.*

Mendojmë se zhvillimi i një strategjie gjithëpërfshirëse për parandalimin e torturës kërkon një qasje të integruar, e cila përbëhet nga tre elementë të ndërlidhur:

- një kornizë ligjore që ndalon torturën dhe mallrat që promovojnë torturën;
- zbatimin efektiv të kësaj kornize ligjore
- mekanizmat për të monitoruar kornizën ligjore dhe zbatimin e saj.

Një kornizë ligjore efektive është thelbësore pjesë e çdo programi dhe vullneti për të luftuar torturën. Megjithatë, ekzistenca e thjeshtë e ligjeve dhe rregulloreve nuk është të mjaftueshme për të parandaluar torturat; ato gjithashtu duhet të kuptohen dhe zbatohen në mënyrë rigoroze.

Ky opsion do të bëjë të mundur:

- Kategorizimin e mallrave që ndalohen apo lejohen për prodhim, importit/eksport apo kalim tranzit nëpërmjet një autorizim paraprak, menjëher me miratimin e rregullimit;
- Vendosjen e mbikëqyrjes nga institucionet shtetërore ndaj veprimtarisë së këtyre mallrave dhe shërbimeve, në një periudhë afatmesme;
- Ndarjen e përgjegjësisë të institucioneve shtetërore dhe operatorëve ekonomikë sipas rolit të tyre si prodhues, eksportues ose importues, brenda një periudhe afatshkurtër;

Opsioni i preferuar është përzgjedhur Opsioni 2, pra hartimi dhe miratimi i një ligji, pasi:

- Kosoto ulët: Bazuar në analizën e mësipërme kosto përfitim është opsioni i cili do të bëjë të mundur adresimin e plotë të problematikave të identifikuara në VN.
- Realizimi i objektivave: Do të bëjë të mundur realizimin e të gjithë objektivave të Qeverisë.
- Përcaktimi i standardeve, mbikëqyrjes së tregut, masave administrative do të rregullojë tregun në këtë fushë të cilat realizohen nga opsione 2 do të sjellin rregullimin e tregut dhe ndalimin e përdorimit për qëllime çnjerëzore apo aksidente me pasoja për shëndetin e qytetarëve.
- Do të zbatohen Konventat në fuqi mbi të Drejtat e Njeriut.
- Do të bëjë të mundur realizimin e objektivit në lidhje me procesin e përafrimit të legjislacionit të BE-së, dhe adresimin e komenteve të Progres Raportit të Komisionit Evropian.

Çështje të zbatimit

- B. *Shpjegoni se cila strukturë do të jetë përgjegjëse për zbatimin e opsionit të zgjedhur.*
- C. *Shpjegoni pengesat e mundshme për zbatimin e opsionit të zgjedhur.*
- D. *Përshkruani masat që do të ndërmerren gjatë zbatimit për të arritur qëllimet e politikës.*

Për zbatimin e opsionit të preferuar dhe monitorimin, do të ngarkohet:

- d) Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve (AKSHE), nën Ministrinë e Mbrojtjes për dhënien ose refuzimin e lejeve nëse aplikanti është i vendosur në Republikën Shqipërisë.
- e) struktura përgjegjëse në Ministrinë e Mbrojtjes (AKSHE) dhe doganat gjatë importit;
- f) organet tjera mbikëqyrëse dhe inspektuese, secila në përputhje me kompetencat e veta.

Pengesat e mundshme për zbatimin e opsionit të zgjedhur janë si vijojnë:

- Moszbatimi korrekt i ligjit nga operatorët ekonomikë.
- Mungesa e rakordimit ndërmjet institucioneve të ngarkuara me zbatimin e ligjit.

Si masa për zbatimin e këtij opsioni, renditen si më poshtë vijon:

- Hartimi i akteve nënligjore (Lista e produkteve të ndaluara dhe kushtet për autorizim do të përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave; Këshilli i Ministrave do të miratojë me vendim, modelet standarde të autorizimeve, formatet e kërkesave të aplikimit për këto dokumente, si dhe kriteret e veçanta dhe procedurat për aplikim dhe afatet, mënyrën dhe procedurën për shkëmbimin e informacionit dhe marrjes së mendimit me institucionet e tjera, të përfshira në transferimet ndërkombëtare të mallrave të kontrolluara, etj.), të cilat do të detajojnë procedurat dhe strukturat përgjegjëse për realizimin e objektivit;
- Përcaktimi i formave/mjeteve të bashkëpunimit ndërmjet aktorëve të përfshirë në zbatimin e ligjit.
- Kryerja e inspektimeve periodike nga autoritetet e mbikqyrjes së tregut.

Faza e monitorimit dhe vlerësimit

E. Jepni një përshkrim të përmbledhur të masave të monitorimit dhe të vlerësimit.

F. Identifikoni kriteret/treguesit për të matur arritjen e objektivave ose progresin drejt tyre.

Monitorimi do të kryhet nëpërmjet inspektimeve pranë operatorëve ekonomikë nga këto struktura:

- a) struktura përgjegjëse në Ministrinë e Mbrojtjes (Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve) për dhënien ose refuzimin e lejeve;
- b) struktura përgjegjëse në Ministrinë e Mbrojtjes (Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve) dhe Doganave gjatë importit dhe eksportit;
- c) organet e tjera mbikëqyrëse dhe inspektuese, secila në përputhje me kompetencat e veta.

Gjithashtu, institucionet e përmendura më sipërme, nëpërmjet raporteve vjetore mbi importet eksportet, përdorimin e fundit të këtyre produkteve, do të zhvilljnë edhe vlerësime mbi zbatimin apo dhe problematika të mundshme të shfaqura, të cilat do të sjellin nevojshmëri për rregullime/përditësim, si dhe përditësimin e listave (sipas atyre të BE-së). Në këtë kuadër, thekosjmë se lista e produkteve mund të miratohet me akte ligjor të cilat janë më të aksesueshme/mundshme për ndryshime dhe rregullime në varësi të problematikës së evidentuar pao nevojshmërisë për përafrim të metëjshme të listave nga ndryshimet e vendosura nga BE .

Indikatori final i suksesit të politikës është:

- a) Sigurimi që detyrimet e të gjithë operatorëve ekonomikë janë më të qarta brenda viti të parë të zbatimit të ligjit të ri;
- b) Ndalimin e shitjes në tregun shqiptar të mallrave që në thelb janë abuzive dhe nuk duhet të tregtohen fare;
- c) Ndalimin e shitjes në tregun shqiptar të këtyre mallrave nga subjekte pa licencë ose nga autoritete që nuk kanë objekt ligjor përdorimin e këtyre mallrave;

Në terma më afatshkurtër, AKSHE duhet të hartojë një raport vjetor të aktivitetit publik, e cila do të përmbajë informacion mbi numrin e autorizimeve të marra, mallrat dhe vendet e prekura nga këto autorizime dhe një informacion në lidhje me vendimet e marra në lidhje me këto kërkesa.

Gjithashtu, politika do të monitorohet në mënyrë të vazhdueshme (analiza 12- mujore) nëpërmjet gjetjeve dhe shkeljeve të konstatuara nga grupet inspektuese:

- Numri i inspektimeve të kryera për monitorimin e zbatimit të ligjit.
- Numri i subjekteve tregtare të sanksionuara si rezultat i këtyre inspektimeve
- Numri i licencave/autorizimeve të dhëna.

Raporti i vlerësimit të ndikimit - Shtojca 2/a

Tabela: Vlera aktuale neto në total (VAN) - kostot dhe përfitimet me vlerë monetare të përcaktuar në milionë lekë e zbritur për 10 vjet (Vlera aktuale e kostos dhe vlera aktuale e përfitimit); krahasuar me status quo-në.

	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Viti 6	Viti 7	Viti 8	Viti 9	Viti 10
Faktori zbritës	1.00	0.95	0.91	0.87	0.82	0.79	0.75	0.71	0.68	0.65
Kosto për buxhetin - një herë	102.400 L	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Kosto për buxhetin - në vazhdimësi	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Kosto për bizneset - një herë	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Kosto për bizneset - në vazhdimësi	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Kosto për grupet e tjera - një herë	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Kosto për grupet e tjera - në vazhdimësi	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Kosto në total	102.400 L	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Kosto e zbritur= Kosto në total x Faktori zbritës		-	-	-	-	-	-	-	-	-
Përfitimet për buxhetin – një herë	nuk llogariten	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a
Përfitimet për buxhetin – në vazhdimësi	nuk llogariten	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a
Përfitimet për grupet e tjera – një herë	nuk llogariten	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a
Përfitimet për grupet e tjera – në vazhdimësi	nuk llogariten	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a
Përfitimet për biznesin – një herë	nuk llogariten	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a

Përfitimet për biznesin – në vazhdimësi	nuk llogariten	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a
Përfitimet totale	nuk llogariten	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a
Përfitimi i zbritur = Përfitimi në total x faktori zbritës	nuk llogariten	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	
Vlera prezente aktuale e përfitimit në total										
Vlera prezente aktuale e kostos në total										
Vlera Prezente Neto Aktuale (VAN) = Vlera aktuale e përfitimit në total – Vlera aktuale e kostos në total										

Raporti i vlerësimit të ndikimit - Shtojca 2/b

Tabelë: Vlera aktuale neto në total e çdo opsioni

Opsioni	Vlera aktuale në milionë lekë		Vlera aktuale neto në milionë lekë
	Kosto	Përfitimi	
Opsioni 1	na	na	na
Opsioni 2	102.400 L	na	102.400 L

MINISTËR

Niko Peleshi